

Data 24.05.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Zhvillim dhe Mirembajtje te sistemit te faturimit

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 48444100-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles kanalizime Kamezka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera mesatare e tyre te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma b) , të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 2, gërma b) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit ndodhet ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshkrimit te auditimit), ku bilancet e dy viteveve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe parashikimeve të Nenit 57 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike"

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate 360 000 leke pa tvsh

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Përcaktimi i vlerës 20% % *te fondit limit pasi është një vlerë lehtësisht e përballueshme dhe nga personat fizik. Kjo për të garantuar autoritetin kontraktor se OE pjesëmarrës kanë kapacitet ekonomik të miftueshëm për përmbushjen e kontratës.*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 5 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj). Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve.

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar si “Arkitekt të Çertifikuar” në zgjidhjen e ofruar. Kjo të vërtetohet nepermjet paraqitjes së Certifikatës së leshuar nga një kompani e licensuar nga autoritetet përkatëse shtetërore. Kjo kompani të jetë vet prodhuesi i sistemit ose përndryshe të jetë e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të leshuar atë lloj certifikate.

Argumentimi: Që të sigurohet aftësia për implementimin e kërkesave për ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteteve, etj, kërkohej që OE duhet të ketë në stafin e propozuar të pakten 2 personel me njohuri/aftësi të nevojshme të certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze të sistemit

- b) Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 1 specialist të certifikuar si “Ekspert I certifikuar” në zhvillim dhe implementim të programeve të faturimit. Kjo të vërtetohet nepermjet paraqitjes së Certifikatës së leshuar nga një kompani e licensuar nga autoritetet përkatëse shtetërore. Kjo kompani të jetë vet prodhuesi i sistemit ose përndryshe të jetë e autorizuar nga prodhuesi i sistemit për të leshuar atë lloj certifikate.

Argumentim: Nevojitet për të garantuar integrimin mes sistemit të faturimit dhe me sistemin e fiskalizimit.

- c) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) nga punonjësit të jene të certifikuar për siguri në cloud.

Argumentim: Nevojitet për të garantuar sigurinë e të dhënave të Autoritetit Kontraktor në Cloud.

- d) Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalent.

Argumentim: Për të menaxhuar dhe vendosur prioritetet e task-ëve që vijnë nga përdoruesit e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm pasi që të sigurohet aftësia për implementimin e kërkesave për ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteteve, etj, kërkohet që OE duhet të ketë në stafin e propozuar personel me njohuri/aftësi të nevojshme të certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze të sistemit si dhe Nevojitet për të garantuar integrimin mes sistemit Flare Billing dhe me sistemin e fiskalizimit në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.3 Operatori Ekonomik konkurues duhet të jete i certifikuar me:

- ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) e perditesuar
- ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) e perditesuar
- BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve të integruar) e perditesuar

*Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mësipërme duhet të paraqiten nga secili OE

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim: Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësia se shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës se tij, ti bazojë në standarde

boterore, te cilat ne menyre direkte ndikojne ne cilesi, shpejtesi, efikasitet dhe te sherbimeve te ofruara qe garantojne iso per sistemin e manaxhimit te cilesise dhe iso per sigurine e informacionit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Sistemi i menaxhimit te integruar eshte i domosdoshem te zbatohet nga OE ne rastet kur ka integrim te dy ose me shume sistemeve sic eshte ne rastin konkret.

Sistemi duhet te mirembahet nga OE dhe respektimi i standardit iso per manaxhimin e sherbimeve IT e garanton kete process.

2.3.4 Autorizimi i Prodhuesit per zgjidhjen e ofruar te Programit te Fiskalizimit, i cili te specifikojë projektin, daten, adresen e qarte te prodhuesit dhe te bashkëngjise certifikaten e regjistrimit te sistemit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Qe te sigurohet aftesia per implementimin e sistemit dhe bazuar ne proceset e punes kritike, rendesise se sherbimeve qe sistemi ofron kerkohej qe OE te ofroje nje sistem i cili eshte i gatshem dhe vetem do te implementohet.

2.3.5 *Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.*

Argumentim: Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019 Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e te mirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike duhet që operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim duhet të jenë të licensuar dhe te regjistruar në regjistrin e prodhuesve ose te mirëmbajtesve software-ike te AKSHI-it

2.3.6 *Oferte Teknike qe permbush specifikimet teknike te dhena ne shtojcen perkatese si dhe te paraqese te dhenat e plota te personit te kontaktit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknik sipas relacionit të ngarkuar në SPE

NJËSIA E PROKURIMIT